



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:069320  
Datë: 19.06.2024  
Numri i dokumentit: 05833981

**PAKR.nr.33/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.R., nga fshati ....., Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.27.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, i akuzuari N.R., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, është liruar nga akuza, në kuptim të nenit 363 par 1 pika 1.3 të KPPK, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe i

akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe ti shqiptohet sanksion penal meritör.

Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit N.R., av.Ymer Huruglica, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.48/2024, të datës 29.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.93/2022, të dt.20.11.2023, të anulohet kurse çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, ose që të ndryshohet dhe i akuzuari N.R., të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe ti shqiptohet dënimi përkatës ligjor.

Sa i përket përgjigjes në ankesë, ka vendosur që e njëjta të refuzohet si e papabazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit për datën 27.05.2024. dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari N.R., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe av.Ymer Huruglica, përkundër asaj që i kanë pranuar njoftimet me rregull.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së prokurorisë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 383 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK, ngase dispozitivi i të njëjtit është i pa qartë, i pa kuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten, si dhe arsyetimin e aktgjykimit, ngase faktet vendimtare nuk japin relacione të qarta lidhur me arsyetimin e aktgjykimit. Me rastin e lirit nga akuza të akuzuarit N.R., jep konstatimin se me asnjërin nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprime të parapara në dispozitiv të aktgjykimit, duke mos vlerësuar saktësinë e provave të paraqitura në aktin akuzues, çka nënkupton se ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Si pasojë e shkeljeve esenciale edhe gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për të cilat është ushtruar ankesa në vijimësi.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, sikurse pretendohet në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm në harmoni me vetveten si dhe arsyet

e dhëna për secilën pikë të aktgjykimit, që nënkupton se përmban arsytet lidhur me faktet vendimtare të cilat, arsyetojnë se aktgjykimi lirues i nxjerrë në këtë çështje penale në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me asnjë provë nga shkorsat e lëndës, përkundër asaj që janë proceduar prova të bollshme, gjykata e shkallës së parë, pasi që nuk ka provuar se në veprimet e të akuzuarit janë formular elementet qenësore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, nuk ka mundur që të vërtetoj se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për çdo pikë të aktgjykimit e cila vërtetohet nga aktgjykimi i ankimuar duke u përkujdesur që të gjitha provat e ngritura kanë bazueshmërinë e duhur juridike, duke u kujdesur që në mënyrë të qartë dhe të plotë të jep sqarime të qarta se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si dhe në mënyrë të qartë ka vlerësuar saktësinë e secilës provë, që e karakterizon çështjen penale, andaj në këtë çështje penale pasi që nuk ka ekzistuar elementi inkriminues i kryerjes së të njëjtës, me qëllim që i akuzuari të përgjigjet për këtë veprë penale, edhe e ka liruar nga akuza.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar edhe për shkak të vërtetimit të ankimuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke liruar nga akuza të akuzuarin N.R., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, ashtu që pas shqyrtimit të të gjitha provave në këtë çështje penale vihet në përfundim se gjendja faktike përkundër asaj që është vërtetuar pasi që janë proceduar dhe vlerësuar të gjitha provat personale, po ashtu edhe ato materiale, sikurse janë dëshmia e të akuzuarit, të dëshmitarëve, si dhe të gjitha provat materiale, sikurse është raporti hetues përfundimtar, konstatimi i inspektorëve të ndërtimit lidhur me objektin e ndërtimit të pronarit B.Q., i cili gjendet në Lagjen “.....”, në Gjilan, konstatimit të objektit se është duke u ndërtuar në Gjilan, pa leje ndërtimore, se i njëjti ka qenë me shirita të vendosur, dhe se për këtë veprim i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 300Euro, aktvendimi për rrënimin e objektit pa leje të ndërtuar, i dt.20.04.2021, me numër të protokollit 14-02-233, i cili aktvendim nuk është ekzekutuar nga i akuzuari, duke e dëmtuar vlerën e taksave të Komunës së Gjilanit, dhe infrastrukturën e qytetit, përkatësisht të lagjes “Dardania I”, vlerësimit të deklaratës së dëshmisë së dëshmitarit F.K., rezulton se të gjitha këto prova në mënyrë të pa dyshimtë karakterizojnë veprimin inkriminues të akuzuarit, që në kuptim të nenit 3 të KPPK, është obligim i organeve që procedojnë në çështje penale, të vendosen për fajësinë e të akuzuarit. Në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka aplikuar parimin “indubio pro reo”, duke pretenduar se mëdyshjet të cilat kanë ekzistuar në interpretimin e deklaratave, kanë shkuar në favor të të akuzuarit, ashtu që një vlerësim i tillë nuk është i drejtë dhe gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur në mënyrë të qartë, përkitazi me fajësinë e të akuzuarit, dhe të njëjtin e ka liruar nga akuza.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me ankesën e ushtruar nga ana e prokurorisë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkresat e tjera të lëndës, de ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qartë, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit N.R., nuk janë formular elementet inkriminuese të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK.

Duke i vlerësuar të gjitha deklaratat personale, sikurse është deklarata e të akuzuarit N.R., i cili thekson se përkundër asaj që ka pasur pozitën e krye shefit të inspektionit në Komunë të

Gjilanit, i ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kuadër të autorizimeve të veta, duke i shpërndarë detyrat e inspektorëve që të bëjnë kontrollimin eventual të ndonjë ndërtimi, e në rastin konkret edhe të ndërtimit pa leje, në objektin e pronarit B.Q., i cili gjendet në lagjen “.....”, në Gjilan. Është konstatuar se objekti është ndërtuar pa leje, i kanë vendosur shirita dhe i kanë shqiptuar gjobën në shumën prej 300 Euro, është nxjerrë aktvendimi për rrënimin e objektit i dt.20.04.2021, me numër të protokollit 14-2-233, mirëpo i njëjti nuk është ekzekutuar, duke theksuar se veprimet e mëtutjeshme kanë qenë në kompetencë të Drejtorisë së Urbanizimit.

Po ashtu edhe dëshmitari A.M., i dëgjuar në cilësinë e inspektorit, ka deklaruar se drejtori nuk ka njohuri, nuk e njeh investitorin dhe sipas njohurive që ka, ai personalisht nuk e dinë që ka realizuar drejtori ndonjë përfitim eventual.

Të njëjtat pohime i jep dëshmitari F.K., i cili ndërmerr të qartë ka bërë përshkrimin e të gjitha veprimeve të ndërmarra duke theksuar se ka ndërmarrë çdo hap i cili është ndarë nga ana e drejtorit, dhe në kuadër të autorizimeve të veta, thekson ka vepruar në fushë veprimtarin e cila i përket, dhe se nuk ka njohuri që nga ana e drejtorit N.R., është kryer ndonjë veprim i kundërligjshëm. Po ashtu në këtë çështje penale janë marrë parasysh edhe të gjitha provat materiale nga shkresat e lëndës, sikurse janë autorizimi i policisë për të intervistuar F.K., aktvendimi për rrënimin e objektit nr.14-02-233/2021, i dt.20.04.2021, në të cilin ekziston konstatimi se është urdhëruar investitori B.Q., që menjëherë të fillojë rrënimin e objektit në lagjen “.....”, nr. ...., dhe ta kthejë në gjendje të mëparshme, procesverbalit mbi inspektimin me nr.14-02-0324, i dt.20.04.2021, në të cilin gjykata ka vërtetuar faktin se inspektori A.M., ka konstatuar se në bazë të ligjit 04/L-110, janë plotësuar kushte që të merret vendimi për rrënimin e objektit në lokacionin “.....”, rruga “.....”, dhe se në bazë të procesverbalit ekziston konstatimi se kanë kaluar 30 ditë nga ndërprerja e punimeve dhe investitori nuk e ka nxjerrë dokumentin me të cilin është pajisur me leje ndërtimore.

Po ashtu nga procesverbalit për inspektim, gjykata ka vërtetuar faktin se investitori B.Q., përkundër faktin që ka pasur urdhrin për ndërprerjen e punimeve, i njëjti ka vazhduar dhe ka marrë gjobë, në shumën prej 300 Euro. Po ashtu edhe nga fotografia nga vendi i ngjarjes, procesverbalit për inspektimin, aktvendimi për ndërprerjen e punimeve, që të gjitha vërtetojnë se të gjitha veprimet përkitazi me ndërtimin e objektit, investitori B.Q., i ka ndërmarrë pa leje.

Që të gjitha provat materiale dhe ato personale në mënyrë të pa dyshimtë vërtetojnë se në këtë çështje penale, përkundër asaj që i akuzuari është akuzuar, për veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, nuk ka mundur që të vërtetohet se ka ekzistuar dashja nga ana e këtu të akuzuarit N.R., për të kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar, se nga kjo çështje penale në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nuk ka realizuar kurrfarë përfitimi pasuror në mënyrë të kundërligjshme dhe se në asnjë mënyrë gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vërtetojë se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale, andaj kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është nxjerr vendim i drejtë në këtë çështje penale, kur i akuzuari është liruar nga akuza pasi që nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar, andaj në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, është liruar nga akuza.

Përkundër asaj që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës në kuptim të nenit 385 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, ngase në këtë çështje penale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, nuk janë

formular elementet qenësore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.3 nën par.3.2 lidhur me par.1 të KPK, e cila vepër penale është e paraparë me ligjin e aplikueshëm.

Po ashtu kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në mënyrë të drejtë është vendosur kur i akuzuari është liruar nga akuza që nënkupton se në këtë çështje penale eksitojnë rrethanat që e kanë përjashtuar nga përgjegjësia penale, si dhe nga ndjekja penale, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, në vendosjen e çështjes penale.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.33/2024, të datës 27.05.2024**

**Procesmbajtës,  
Endrit Ajeti**

**Anëtarët e kolegjit,  
Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,  
Xhevdet Abazi**

**Kadrije Goga Lubishtani**